



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 487, datë 21.09.2023

PËR

**HAPJEN E PROCEDURËS SË KOMANDIMIT NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË
LARTË TË DREJTËSISË DHE SHPALLJEN E KËRKESËS PËR KANDIDATURA
NGA RADHËT E GJYQTARËVE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “ë”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “d” të nenit 86, në shkronjë “b”, pika 1, të nenit 97, në pika 1 dhe 5 të nenit 209 dhe në nenin 211, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenet 53, 54, 55, 57 dhe 58, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sipas shkresës nr. 2459/1 prot., datë 31.07.2023, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

I. Hapja e procedurës dhe shpallja e kërkesës për kandidatura

1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për 2 (dy) pozicione të lira si inspektor.
3. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është deri më datë 05.10.2023.
4. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:
 - a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për komandimin në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
 - b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
 - c) Fotokopje të kartës së identitetit;

- ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
- d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të shkronjës “dh”, pika 5, të nenit 209, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
- dh) Vërtetim/Dëshmi nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore) për mosqenien i dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

Dokumentacioni sipas pikës 4, të këtij vendimi, dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Kohëzgjatja, kushtet, kriteret dhe procedura e komandimit

5. Kohëzgjatja e komandimit është deri në pesë vjet.
6. Kohëzgjatja e komandimit mund të përfundojë para afatit:
 - a) me kërkesë të gjyqtarit të komanduar, për shkaqe të justifikuara;
 - b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit;
 - c) kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore;
 - ç) kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen;
 - d) kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra.
7. Kushtet e përgjithshme të komandimit:
 - a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;
 - b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;
 - c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;
 - ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë:
 - i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;
 - ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës.
8. Kushtet e veçanta të komandimit:
 - a) Kandidati duhet të plotësojë kushtet për emërim në Gjykatën e Lartë, si më poshtë:

- i) të ketë ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;
 - ii) të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;
- b) në kohën e kandidimit, të mos jetë kryetar i një gjykate ose anëtar i organeve drejtuese të grupeve të interesit, të tilla si shoqata ose sindikata magjistratësh etj;
 - c) të jetë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale;
 - ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - d) të mos jetë i dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - dh) në kohën e kandidimit, të mos ketë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të Ligjit “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ose të afërm të shkallës së parë, që punon si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
9. Plotësimi i kushteve të kandidimit, me përjashtim të atij sipas shkronjës “a”, pika 7 dhe shkronjës “c”, pika 8, të këtij vendimi, verifikohen sipas procedurës së përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.
10. Kandidati, që me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet se plotëson kushtet e kandidimit, me përjashtim të atij sipas shkronjës “a”, pika 7, të këtij vendimi, i nënshtrohet vlerësimit etik dhe profesional sipas Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe Vendimit të tij nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, ose Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” dhe Vendimit të tij nr. 209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”.
11. Këshilli mund të vendos në çdo kohë përjashtimin nga komandimi kur verifikohet që kandidati nuk plotëson qoftë edhe një prej kushteve të komandimit, me përjashtim të atij sipas shkronjës “a”, pika 7, të këtij Vendimi.

12. Brenda dy javëve pas përfundimit të verifikimit të kushteve të kandidimit sipas pikës 9, si dhe të vlerësimit etik dhe profesional sipas pikës 10, të këtij vendimi, për të gjithë kandidatët që rezultojnë me nivel vlerësimi të paktën “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli mund të vendos përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin.
13. Emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet për komandim, së bashku me Opinionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, i përcillen menjëherë për vlerësim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
14. Përzgjedhja e kandidatëve për vendet vakante në pozicionin e inspektorit, bëhet me vendim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
15. Brenda dy javëve nga marrja e vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kërkesës së tij për komandim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin e gjyqtarëve të përzgjedhur, në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

VETËDEKLARIM
PËR
MASA DISIPLINORE

Unë gjyqtari/ja _____ (*emër, atësia, mbiemri*), në cilësinë e kandidatit në procedurën e komandimit në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

DEKLAROJ SE:

Nuk kam masë disiplinore në fuqi.

Lëshuar më _____.____.2023

DEKLARUESI

(Emri, atësia, mbiemri)
(Nënshkrimi)

VETËDEKLARIM

PËR
SITUATËN E PAPAJTUESHMËRISË AMBIENTALE

Unë gjyqtari/ja _____ (*emër, atësia, mbiemri*), në cilësinë e kandidatit në procedurën e komandimit në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në shkronjën “dh”, pika 5, të nenit 209, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

DEKLAROJ SE:

Nuk kam asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të Ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, dhe të afërm të shkallës së parë, që punon si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Lëshuar më _____.____.2023

DEKLARUESI

(Emri, atësia, mbiemri)
(Nënshkrimi)